



Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë

Përfaqësuesi i Lirisë së Medias

ANALIZË DHE RISHIKIM

I

LIGJIT 8410 I VITIT 1998 (i ndryshuar)

PËR RADION DHE TELEVISIONIN PUBLIK

NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Nga

Karol Jakubowicz, Ph.D.

Drejtor, Departamenti i Strategjisë dhe Analizës

Këshilli Kombëtar i Transmetimit të Polonisë

Zëvendëskryetar, Komiteti Drejtues i Mjeteve të Komunikimit Masiv,

Këshilli i Evropës

Gusht 2004

HYRJE

Ky rishikim, i porositur nga Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias, ka për qëllim të përcaktojë nëse Ligji Nr.8410 i vitit 1998 (i ndryshuar) për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat në Republikën e Shqipërisë është në përputhje me standartet evropiane dhe nëse i plotëson kriteret për një rregullim të efektshëm të transmetimit në Shqipëri sipas “Parimeve Themelore për Zhvillimin e Veprimtarisë Radiotelevizive”, siç përkufizohet në nenet 4 dhe 5 të këtij ligji.

Me “standarte evropiane” do të kemi parasysh, kryesisht, standartet e përcaktuara nga vetë OSBE-ja¹, ashtu si edhe ato të vendosura nga Këshilli i Evropës, që rrjedhin kryesisht nga neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe që zhvillohen më tej në një numër konventash, rekomandimesh dhe deklaratash të Komitetit të Ministrave, si dhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Duke pasur parasysh negociatat e Shqipërisë për pranimin e saj në të ardhmen në Bashkimin Evropian², do të kemi parasysh, gjithashtu, edhe kriteret e BE-së.

BE-ja vlerëson gatishmërinë e vendeve kandidate për t’u bashkuar në bazë të kriterëve të Kopenhagenit, duke përfshirë kriteret politike, ku “anëtarësimi kërkon që vendi kandidat të sigurojë stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokraci, shtet të së drejtës, të drejtat e njeriut, si dhe respektim dhe mbrojtje të pakicave”. Kjo përcaktohet duke analizuar institucionet politike dhe marrëdhëniet midis tyre për të vlerësuar se si funksionon demokracia realisht në praktikë, se si zbatohen të drejta dhe liri të ndryshme, si për shembull liria e shprehjes, nëpërmjet, për shembull, rolit të partive politike, organizatave joqeveritare dhe medias dhe, veçanërisht, respektimi i të drejtave themelore, duke përfshirë lirinë e shprehjes dhe lirinë për t’u mbledhur në organizata të ndryshme.

Neni 6 i Traktatit për Bashkimin Evropian shprehet se BE-ja i respekton të Drejtat Themelore të garantuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë lirinë e shprehjes dhe informimit. Në mënyrë më të përgjithshme, BE-ja i referohet shpesh “standarteve evropiane” në fushën e medias, ashtu siç përcaktohet nga Këshilli i Evropës dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. BE-ja mbështetet, gjithashtu, edhe në Kartën e saj të të Drejtave Themelore.

Përsa i përket kapitullit 20 (politika kulturore dhe audiovizive) të negociatave të pranimit, ai përqendrohet në shkallën e përafrimit të legjislacionit vendas të transmetimit

¹ Shih i.a. Liria e Shprehjes, Rrjedha e Lirë e Informacionit, Liria e Medias. CSCE/OSCE Dispozitat kryesore 1975-1999. Vjenë: Përfaqësuesi për Lirinë e Medias, korrik 2000; OSBE Angazhimet, Dimensioni Njëzëzor, Udhëzues. Varshavë: ODIHR, 2001

² Shih Deklaratën e miratuar në Samitin e Ballkanit Perëndimor dhe BE-së në Selanik, 21 qershor 2003, ku BE-ja përsëriti mbështetjen e saj ndaj perspektivës evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Shqipërinë, dhe deklaroi se “Shpejtësia e ecjes përpara është në duart e vendeve të rajonit”.

me kuadrin ligjor të BE-së, dhe, kryesisht, direktivës për Televizione pa Kufij (Television Without Frontiers –TWF). Në qershor 1995, Këshilli Evropian në Madrid vuri në dukje rëndësinë jo vetëm të përfshirjes së *acquis* (*Shënim i përkthyesit: Termi *acquis* ose ndonjëherë *acquis communautaire*, që vjen nga frëngjishtja, përdoret në Ligjin e Bashkimit Evropian për t'iu referuar tërësisë së ligjeve të BE-së të arritura deri tani. Ky term përdoret gjithashtu edhe për të përshkruar arritjet e Këshillit të Evropës.*) në legjislacionin vendas, por edhe të zbatimit me efektshmëri të tij nëpërmjet strukturave të duhura administrative. Kjo formon bazat e një vlerësimi sistematik të kapaciteteve administrative të vendeve candidate që bëhet në kontekstin e negociatave të pranimit.

I. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I LIGJIT

Ky ligj siguron një kuadër relativisht të plotë, të gjerë dhe të hollësishëm për rregullimin e transmetimit. Sipas standarteve të përgjithshme evropiane dhe organizimit demokratik të sistemit të transmetimit, ky ligj i jep shumë pushtet të drejtpërdrejtë Kuvendit për transmetimin, duke e ulur potencialisht pavarësinë si të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT), ashtu dhe të transmetuesit publik. Gjithashtu, ai fut një kontroll qendror dhe licensimin e fushave të veprimtarive që nuk licensohen në vende të tjera.

Sidoqoftë, nuk është e sigurt se ky ligj i jep KKRT-së një status dhe peshë të mjaftueshme, që ajo të mund t'i kryejë detyrat e saj me efektshmëri dhe të merret me shtetin dhe organet qeveritare në kryerjen e detyrave të tij.

Ligji nuk kërkon dhe as nuk garanton pavarësinë e organizmit të transmetimit publik, gjë që përbën në vetvete një largim të madh nga standartet evropiane. Duke i dhënë Kuvendit autoritetin për të miratuar statutin e transmetuesit publik, ky ligj i jep Kuvendit kontroll mbi çdo aspekt të organizimit të transmetuesit publik dhe veprimtarive të tij, duke parandaluar ndryshimin e shpejtë të strukturave, kompetencave ose metodave të funksionimit që një transmetues publik që vepron në një treg konkurrues duhet të jetë në gjendje të bëjë ose të ketë.

Ligji duket se ka parasysh një situatë statike nga këndvështrimi teknologjik. Shumë nga dispozitat e tij janë të ngurta dhe joelastike, duke mos ofruar asnjë procedurë për ndryshime, kur kjo të jetë e nevojshme.

II. KOMENTE TË PËRGJITHSHME MBI LIGJIN

1.

Megjithëse disa terma të përdorura në ligj përkufizohen në vende të ndryshme, qartësia dhe siguria ligjore do të ishin më të mëdha në qoftë se të gjitha përkufizimet e nevojshme do të ishin në përputhje me praktikën evropiane dhe do të grupoheshin në një nen dhe, më pas, të aplikoheshin në mënyrë të njëtrajtshme në tekstin e ligjit.

2.

Ligjit duket se i mungon asnjëra teknologjike, që çon në dispozita të ndara për licensimin e programeve të transmetuara në mënyrë tokësore, kabllore dhe satelitore. Kjo e komplikon ligjin në mënyrë të panevojshme.

3.

Në kohën kur është hartuar ky ligj, në Shqipëri, nuk ka pasur një ligj të përgjithshëm për shtypin ose median. Nga kjo vjen edhe përfshirja e dispozitave (nenet 44, 45, 47) për fshehtësinë e burimeve të informacionit, përgjegjësinë për përmbajtjen e programeve, të drejtën e replikës, etj, që normalisht do të vendoseshin në një ligj të tillë. Këto dispozita nuk janë gjithmonë në përputhje me standartet evropiane.

4.

Ligji krijon një sistem kontrolli dhe licensimi të centralizuar të llojeve të veprimtarive që në vende të tjera trajtohen ndryshe. Kjo nënkupton licensimin dhe kontrollin e prodhimit të programeve, licensimin e operatorëve kabllorë, të operatorëve me përforcues tokësorë që ritransmetojnë programe të huaja. Dispozita të tilla përbëjnë arsye për t'u shqetësuar, pasi ato parashikojnë kontrole të tepruara mbi aspekte të rëndësishme të ushtrimit të lirisë së shprehjes dhe lirisë për të dhënë dhe marrë informacion.

5.

Kuvendit i janë dhënë kompetenca të gjera dhe një pushtet i madh i drejtpërdrejtë mbi KKRT-në dhe Radiotelevizionin Shqiptar (RTSH). Megjithëse sipas nenit 8, KKRT-ja duhet të "veprojë në mënyrë të pavarur", kjo e vë në dyshim serioz pavarësinë e që të dy këtyre elementeve kyç të sistemit shqiptar të transmetimit, duke përbërë një çënim serioz të mundshëm të standarteve evropiane (shih më poshtë).

Kuvendi propozon 6 nga 7 anëtarët e KKRT-së dhe i emëron të 7, duke përcaktuar, gjithashtu, edhe shpërblimin e tyre. Ai emëron, gjithashtu, edhe Kryetarin e saj. Komisioni i Përhershëm për Mjetet e Informimit Publik merr në shqyrtim deklarin vjetor financiar dhe raportin e KKRT-së. Raporti i paraqitet Komisionit për Mjetet e Informimit Publik, si dhe gjithë Kuvendit. Kuvendi ka pushtetin ta kthejë raportin e KKRT-së, duke çuar potencialisht në shkarkimin e gjithë anëtarëve dhe emërimin e anëtarëve të rinj.

Përsa i përket RTSH-së, Kuvendi zgjedh Këshillin e tij Drejtues. Ai miraton, gjithashtu, edhe statutin e RTSH-së dhe çdo ndryshim në të, si dhe shqyrton raportin vjetor mbi veprimtaritë e RTSH-së.

E gjithë kjo do të thotë çënim i parimit të ndarjes së pushteteve. Ndërhyrja e Kuvendit në funksionimin e shërbimit të transmetimit publik duhet të ndalojë tek niveli statutor. Roli i Kuvendit është të përcaktojë kuadrin ligjor dhe jo të ushtrojë pushtet administrativ në lidhje me strukturën, organizimin dhe veprimtarinë e përditshme të RTSH-së, siç përcaktohet në Statut.

Në një rishikim të ardhshëm të këtij ligji, duhet të mendohet seriozisht për ta ndryshuar këtë situatë, pasi, siç është, ajo mund të tregojë një shkallë të konsiderueshme varësie të organit rregullues dhe transmetuesit publik nga interesat politike të përfaqësuara në Kuvend.

6.

Disa dispozita të ligjit duket se janë shprehëse të një tendence kundër shërbimeve të programeve të huaja që hyjnë në Shqipëri dhe të japin përshtypjen se Shqipëria kërkon ta shtrijë juridiksionin e saj që të përfshijë këto programe. Këto dispozita nuk mund të jenë në përputhje me standartet evropiane. Zbatimi i kapitujve IX dhe X nga KKRT-ja kërkon një analizim shumë të kujdesshëm (as vetë ligji dhe as përkthimi që nuk është i përsosur nuk japin baza të mjaftueshme për një të kuptuar dhe analizë të plotë të vetë kuadrit ligjor, duke lënë mënjanë praktikën e zbatimit të tyre) përse i përket përputhshmërisë me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila garanton lirinë për të pasur opinione dhe për të marrë dhe dhënë informacione dhe ide pa u penguar nga autoritetet publike dhe pavarësisht nga kufijtë.

7.

Ligji i jep një rëndësi të mjaftueshme të drejtave të pakicave, siç përcaktohet në një numër dokumentesh të OSBE-së dhe Këshillit të Evropës, ndërkohë që, në të njëjtën kohë, parashikon kërkesa të tepërta dhe të pajustificueshme përse i përket gjuhës së transmetimit.

8.

Mbetet për t'u bërë një punë e madhe për të arritur një nivel të kënaqshëm përafrimi me standartet e BE-së. Me përjashtim të dispozitave bazë për reklamat (por jo *teleshopping*) (*Shënim i përkthyesit: Direktiva TWF e përshkruar "teleshopping" si "oferta mallrash ose shërbimesh që i bëhen drejtpërdrejt publikut, duke përfshirë pasuri të paluajtshme, të drejta dhe detyrime në shkëmbim të një pagese"*), fushat ku harmonizimi ende mbetet për tu arritur përfshijnë të gjitha rregullat dhe parimet e direktivës TWF, duke përfshirë disa aspekte të lirisë së marrjes dhe ritransmetimit, juridiksionit, ngjarjet me rëndësi madhore për shoqërinë, nxitja e shpërndarjes dhe prodhimit të programeve televizive (kuota evropiane, kuota për prodhimin e pavarur), mbrojtja e të miturve dhe e rendit publik.

E njëjta gjë është e vërtetë edhe për rregullat e BE-së përse i përket ndihmës që shteti u jep transmetuesve publikë.

III. KOMENTE TË HOLLËSISHME PËR LIGJIN

Nenet 1, 2, 3, 7, 73.

Nenet 1 dhe 2 shprehen se "ky ligj rregullon veprimtarinë e radios dhe televizionit publik e privat në Shqipëri" dhe, më pas, përkufizojnë "veprimtarinë radiotelevizive", duke përfshirë "prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji nëpërmjet zërit, figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit, të

destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kabllave, përsëritësve, satelitëve apo me çdo mjet tjetër.”

Ky përkufizim i fushës së zbatimit të këtij ligji ngre potencialisht probleme serioze për shkak të:

- shtrirjes së tij deri në “prodhimin” e programeve
- sugjerimin e nënkuptuar se mund të mbulojë shpërndarjen e programeve nëpërmjet internetit (“çdo mjet tjetër”).

Për çështjen e parë, kjo do të thoshte rregullim nga shteti i “prodhimit” të programeve. Në këtë këndvështrim, dispozita e nenit 3 (“Për të ushtruar një veprimtari radiotelevizive private, çdo subjekti fizik apo juridik i lëshohet licencë”) mund të interpretohet se licenca nevojitet jo vetëm për të transmetuar një program, por edhe për të prodhuar përmbajtjen e atij programi. Në fakt, neni 73 përmend “subjekte të licencuara për prodhimin e programeve audio e video ose të filmave”, megjithëse nuk përmendet se kush i licencon këto “subjekte” (d.m.th. mund të jenë edhe prodhues të pavarur) dhe mbi çfarë bazash, apo nëpërmjet çfarë procedurash.

Pastaj, neni 7, pika 10, i jep në mënyrë të qartë Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit pushtetin të “caktojë norma prodhimi dhe transmetimi për mediat elektronike publike dhe private.”

Kjo (i) potencialisht shkel lirinë gazetareske dhe artistike dhe shkon ndjeshëm përtej kufijve të ndërhyrjes së shtetit në ushtrimin e lirisë së shprehjes të përcaktuar nga neni 10 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe (ii), në mënyrë të pajustificuar, e shtrin legjislacionin dhe mbikëqyrjen e procesit nga ana e shtetit deri në procesin e prodhimit të programeve, që duhet trajtuar si një fushë e parregulluar e veprimtarisë krijuese dhe/ose sipërmarrëse.

“Veprimtari transmetuese” siç kuptohet në ligjin ndërkombëtar, nuk përfshin në përkufizimin e vet prodhimin e programeve. Në fakt, mund të jesh transmetues pa prodhuar asnjë minutë program.

Neni 1 i Direktivës TWF e përkufizon “transmetimin televiziv” si “transmetimin fillestar nëpërmjet mënyrës kabllore ose ajrore, duke përfshirë atë satelitore, në formë të koduar ose jo të koduar, të programeve televizive të destinuara për t’u marrë nga publiku. Ai përfshin komunikimin e programeve midis ndërmarrjeve për t’iu transmetuar publikut”. Pastaj, përkufizon “transmetuesin” si “personin fizik ose juridik që ka përgjegjësi editoriale për hartimin e planeve të programeve televizive [...] dhe që i transmeton ose bën që të transmetohen nga të tretë”. Një përkufizim i njëjtë për “transmetuesin” mund të gjendet në nenin 2 të Kartës Evropiane për Televizionin Transkufitar.

Rregullimi duhet, për rrjedhojë, të merret me përgjegjësinë editoriale të transmetuesit për përmbajtjet e programeve dhe jo veprimin e prodhimit të programit. Kjo çon, gjithashtu, tek nevoja për një hartim më të kujdesshëm e më të

gjerë të përkufizimeve të termave të përdorura në këtë ligj, që do të ishte ideale të bëhej në një nen të veçantë kushtuar këtij qëllimi.

Përsa i përket çështjes së dytë, asgjë në këtë ligj nuk e mbështet zbatimin e tij të mundshëm në transmetimin përmes internetit, streaming media³ ose përmbajtjen në multimedia të disponueshme në internet. Megjithatë, mund të zbatohet në këtë mënyrë. **Vështirë të ketë qenë synimi i ligjvënësit shtrirja e qëllimit të këtij ligji përtej sferës së transmetimit, por formulimi aktual i nenit 2 mund të krijojë pasiguri ligjore për ofruesit e përmbajtjes në Internet, veçanërisht, në rastin e përmbajtjes së multimedias.**

Neni 6, 137/5

Ky nen e përshkruan Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT) si një “organizëm të pavarur që vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të këtij ligji”.

Në kryerjen e detyrave të veta, KKRT-ja duhet të ketë marrëdhënie me ligjvënësin, si dhe me qeverinë dhe gjyqësorin. Përshkrimi i saj si një “organizëm i pavarur” nuk e përkufizon si duhet statusin e këtij këshilli në mënyrë të tillë që t’i japë një pozicion mjaftueshmërisht të fortë në lidhje me Kuvendin, qeverinë dhe administratën shtetërore.

Kjo ishte ndoshta arsyeja që u shtua neni 137/5, kur u ndryshua ligji në vitin 2000, por kjo është vetëm një zgjidhje e pjesshme, duke siguruar bashkëpunim nga publiku vendas dhe autoritetet policore.

Statusi formal i Këshillit duhet përkufizuar në mënyrë më saktë, veçanërisht, lidhur me vendin e tij përballë organeve të tjera shtetërore në nivel kombëtar.⁴

Neni 7

Ndër pushtetet dhe kompetencat e tjera dhënë KKRT-së, janë edhe ato për të “dhënë dhe hequr licenca për vendosjen e transmetuesve përforcues radiotelevizivë që ritransmetojnë programe të huaja për zona të ndryshme të vendit” dhe për të “dhënë dhe hequr licenca për ritransmetim të radiove dhe televizioneve të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë për publikun në Shqipëri”.

Ushtrimi i këtyre kompetencave duhet të kryhet nën këndvështrimin e zbatimit të një larmie të gjerë të teksteve ndërkombëtare ligjore dhe politike, që garantojnë lirinë për

³ Shpërndarja e informacionit multimedia në kohë reale sidomos në internet.

⁴ Neni 20 i Ligjit Francez për Lirinë e Komunikimit Akti Nr 86-1067 i datës 30 shtator 1986 (i ndryshuar) shprehet se “Për kryerjen e detyrave të ngarkuara Këshillit të Lartë për Mjetet Audiovizive *el* sipas këtij akti, kryetari do të ketë pushtetin të ndërmarrë veprime ligjore në emër të shtetit”. Neni 5 i ligjit polak mbi transmetimin i vitit 1992 (i ndryshuar) përkufizon Këshillin Kombëtar të Transmetimit si “autoritetin shtetëror kompetent për çështjet e transmetimit radioteleviziv”.

të marrë dhe dhënë informacion, pavarësisht nga kufijtë, duke përfshirë Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut, dokumentin e miratuar në Takimin e Kopenhagenit të Koferencës së Dimensioneve Njerëzore të KSBE-së (qershor 1990), si dhe nenin 4 të Konventës Evropiane të Televizionit Transkufitar, dhe nenin 2a të Direktivës TWF– që garanton si lirinë e marrjes, ashtu edhe atë të ritransmetimit të programeve televizive transkufitare.

Ligji duhet të garantojë se KKRT-ja nuk do t'i ushtrojë këto kompetenca duke shkelur këto parime.

Neni 8, 11, 13

Sipas këtij neni, “Buxheti i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit përballohet nga shteti në një masë të tillë që të lejojë funksionimin normal të tij”. Nëse nuk ka gabim në përkthim, kjo mund të nënkuptojë se KKRT-së nuk i sigurohet një buxhet i qendrueshëm dhe se shteti mund të vendosë në çdo çast se buxheti duhet shkurtuar.

Përveç kësaj, pagesa e anëtarëve të këtij këshilli përcaktohet nga Kuvendi – duke mos garantuar përsëri nivelin ose qëndrueshmërinë e tyre.

Të dyja këto dispozita i japin Shtetit dhe Kuvendit liri të konsiderueshme në përcaktimin e nivelit të financimit të KKRT-së dhe nivelit të shpërblimit të anëtarëve të KKRT-së. Kjo mund të përdoret potencialisht për të ushtruar presion mbi autoritetin rregullator, ose për të penguar punën e tij.

Nëse është kështu, kjo do të ishte drejtpërdrejt në kundërshtim me parimet e parashtuara në Rekomandimin (2000) 23 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Pavarësinë dhe Funkcionet e Autoriteteve Rregullatore për Sektorin e Transmetimit. Rekomandimi u bën thirrje vendeve anëtare të “përfshijnë dispozita në legjislacionin e tyre dhe masa në politikat e tyre, duke u dhënë autoriteteve rregullatore për sektorin e transmetimit pushtetin që do t’iu mundësonte përmbushjen e misioneve të tyre, siç parashikohet nga ligji vendas, në mënyrë të efektshme, të pavarur dhe transparente”. Shtojca në këtë rekomandim kërkon që rregullimet ligjore për financimin e autoriteteve rregullatore të specifikohen në ligj në përputhje me një plan të perkufizuar qartë, së bashku me një referencë të kostos së vlerësuar të veprimtarive të autoriteteve rregullatore, në mënyrë që t’iu jepet mundësi që ata t’i përmbushin funksionet e tyre në mënyrë të plotë e të pavarur. Gjithashtu, autoritetet publike nuk duhet të përdorin pushtetin e tyre vendimmarrës për të ndërhyrë në pavarësinë e autoriteteve rregullatore. Rregullime ligjore për financimin duhet të shfrytëzohen, “kur duhet”, mekanizma që nuk varen nga vendimmarrja e posaçme e organeve publike apo private.

Neni 8 nuk arrin t’i përmbahet asnjë prej këtyre parimeve, duke e lënë KKRT-në të prekshme ndaj ekzaktësisht rreziqeve të përshkruara në Rekomandimin (2000) 23.

Ekziston një nevojë e qartë që kjo të ndryshohet në një rishikim të ardhshëm të ligjit.

Varësia e KKRT-së nga financimi publik lehtësohet disi nga burime të tjera financimi të renditura në nenin 11. Megjithatë, mundësia që të marrë donacione, pavarësisht nga të gjitha masat mbrojtëse të renditura në nenin 13, mund ta lërë atë të prekshme ndaj ndikimit ose presionit të jashtëm.

Neni 9, 15

Anëtarët e KKRT-së emërohen nga Kuvendi. Një kandidat propozohet nga Presidenti i Republikës; gjashtë të tjerët propozohen nga Komisioni Parlamentar për Mjetet e Informimit Publik, duke përfaqësuar në mënyrë të barabartë partitë në pushtet dhe partitë opozitare në Kuvend. Gjithashtu, Kryetari i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit zgjidhet nga Kuvendi prej shtatë anëtarëve të tij, nga dy kandidatura të propozuara me votim të fshehtë nga KKRT-ja.

Anëtarët e KKRT-së mund të lirohen nga detyra nga Kuvendi kur:

- dënohen nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- bëhen të paaftë për të kryer detyrat për shkak sëmundjeje;
- mungojnë brenda një viti në më shumë se një të tretën e mbledhjeve të Këshillit;
- vërtetohet se nuk respektojnë papajtueshmëritë në nenin 14

Ndërkohë që arsyet për largim të mundshëm nga puna janë në një masë të madhe në përputhje me parimet e parashtruara në Rekomandimin (2000) 23, metoda e emërimit nuk mund të thuhet se plotëson kërkesën që “autoritetet rregullatore nuk duhet të jenë nën ndikimin e pushtetit politik” dhe “nuk mund të marrin ndonjë mandat ose ndonjë udhëzim nga ndonjë person apo organ”.

Ashtu si edhe me Këshillin Drejtues të RTSH-së (shih më poshtë), shoqërisë civile dhe organizatave të profesionistëve u duhet dhënë një rol i qartë në propozimin e të gjithë (ose një shumice të qartë) anëtarëve të KKRT-së, që do të emëroheshin më pas nga Kuvendi. Kjo do të përmbushte kërkesën e specifikuar në Rekomandimin (2000) 23 që ata duhen emëruar në mënyrë demokratike dhe transparente.

Neni 10

Ky nen, që merret me organizimin dhe funksionimin e KKRT-së, është i rëndësishëm përse i përket negociatave të ardhshme për pranimin në Bashkimin Evropian.

Një dokument i Komisionit Evropian i quajtur “Strukturat kryesore administrative të kërkuara për zbatimin e Acquis” (Bruksel, 10 prill 2002) specifikon një sërë kriteresh që zbatohen në fushën e politikës audiovizive. Kjo përfshin faktin që sistemet rregullatore duhet të kenë kompetenca bazë që lejojnë aplikimin dhe zbatimin efikas të legjislacionit

audioviziv. Lidhur me *acquis* audioviziv, sistemet rregullatore duhet të jenë në gjendje të trajtojnë nocione bazë si ligji i zbatueshëm, juridiksioni, masat për promovimin e veprave evropiane dhe të pavarura, rregullimi i reklamave, tele-shopping dhe sponsorizimi, mbrojtja e të miturve dhe e drejta për replikë.

Kompetenca të tilla përfshijnë nevojën për:

- pushtet të mjaftueshëm monitorues: aftësinë për të monitoruar outputin (rezultatit) e përmbajtjes së transmetuesve, përfshi mundësinë për të detyruar transmetuesit të japin të dhëna për veprimtarinë e tyre transmetuese. Sistemet rregullatore duhet të jenë në gjendje t'i japin Komisionit raporte të hollësishme mbi zbatimin dhe respektimin e legjislacionit të transmetimit. Aftësia për të ushtruar kompetenca të tilla presupozon që sistemet rregullatore kanë lehtësirat e mjaftueshme teknike, ekspertizën teknike dhe burime njërëzore të mjaftueshme për të kryer funksionet monitoruese.
- kompetenca të mjaftueshme sanksionuese: aftësia për të vënë një sërë sanksionesh për shkelje të ligjit dhe/ose kushteve të licensës, vlerësuar sipas seriozitetit të shkeljes. Këto kompetenca duhet të përfshijnë mundësinë për të dhënë paralajmërime, për të vënë gjoba dhe, së fundi, pushtetin për të ndaluar transmetimin/për të hequr licencën e transmetimit (për shkelje të rënda të ligjit, duke marrë në konsideratë natyrën ndërkufitare të *acquis* audio-vizive). Sistemeve rregullatore duhet t'iu jepen kompetenca të tilla në një mënyrë që të mundësojë zbatimin transparent.

Në bazë të vetë ligjit, nuk është e mundur të gjykojmë nëse KKRT-ja e ka kapacitetin administrativ që kërkohet për ekzekutimin e këtyre detyrave. Megjithatë, kjo duhet parë me kujdes kur të analizohet efektshmëria e ligjit dhe kur të fillojnë përgatitjet për negociatat e pranimit.

Kapitulli IV “Licencimi”

Ky kapitull i referohet vetëm licencimit të programore të transmetuara në mënyrë tokësore, ndërkohë që licencimi i “programeve radiotelevizive kabllore” dhe transmetimit satelitor mbulohet diku tjetër. Kjo do të thotë se ligji nuk është asnjans nga ana teknologjike dhe se krijon regjime të ndryshme ligjore për teknologji të ndryshme transmetimi. Të gjitha rastet e dhënies së licencave për transmetim duhet të mbulohen në këtë kapitull.

Neni 20

Disa dispozita të këtij neni kanë nevojë për rishikim:

1. Fakti që mund të lëshohen vetëm licenca kombëtare dhe vendore.
2. Fakti që vetëm shoqëri anonime të themeluara në territorin e Republikës së Shqipërisë mund të marrin licenca kombëtare transmetimi;
3. Dhe fakti që këto duhet të jenë shoqëri anonime, qëllimi i vetëm i të cilave është veprimtaria radiotelevizive.

Këto dispozita përbëjnë kryesisht një çështje zgjedhjeje politike për Shqipërinë dhe nuk ngrihet çështja e pajtueshmërisë së tyre me standartet evropiane. Sidoqoftë, ato meritojnë t'iu kushtohet vëmendje.

Mund të mendohet se kushti sipas të cilit vetëm shoqëritë anonime mund të marrin licenca kombëtare ka pasur për qëllim nxitjen e transparencës së pronësisë dhe financimit (një parim i mbështetur gjithashtu edhe nga Rekomandimi Nr. R (94) 13 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Masat për Nxitjen e Transparencës së Medias). **Megjithatë, në sisteme të tjera ligjore, edhe individët kanë mundësi të kërkojnë dhe t'iu jepet licence kombëtare transmetimi.**

Kushti për dhënien vetëm të licensave kombëtare dhe vendore mund të ketë pasur si qëllim mbrojtjen e stacioneve vendore radiotelevizive, dhe, si rrjedhojë, programet që pasqyrojnë çështje me rëndësi për komunitetet vendore (shih, gjithashtu, nenin 29). **Megjithatë, në shumë juridiksione të tjera, licencohen edhe stacione rajonale. Për më tepër, duke pasur parasysh numrin relativisht të madh të stacioneve televizive (56 në nëntor 2003) dhe tregun me siguri të vogël të reklamave, nuk dihet me siguri nëse stacionet vendore janë me të vërtetë në gjendje të prodhojnë shumë programe të reja dhe me vlerë.**

Përfundimisht, kushti që licencat kombëtare mund t'iu jepen vetëm shoqërive anonime “të themeluara me qëllimin e vetëm për kryerjen e veprimtarisë radiotelevizive” mund të kuptohet si një kusht që pasqyron dëshirën për të mbrojtur transmetimin nga presionet e padëshiruara ekonomike dhe komerciale, që mund të ishin të pashmangshme në qoftë se ato do të ishin pjesë e enteve më të mëdha ekonomike. **Megjithatë, efekti i padëshiruar i kësaj dispozite mund të jetë dobësia financiare e stacioneve kombëtare të transmetimit, që mund të çojnë në pamundësinë e tyre për të ofruar programe origjinale dhe t'i bëjë ata të pambrojtur përballë presioneve, pasi ata kërkojnë burime financimi. Kjo mund të jetë, gjithashtu, edhe pasoja e padëshiruar e një dispozite relativisht strikte që do të ishte kundër përqendrimit dhe pronësisë së tërthortë, përcaktuar në nenin 20 dhe gjetkë.**

Nenet 23, 24

Neni 23 kërkon që kërkesa për licencë të përcaktojë “përmbajtjen e programeve që do të transmetohen”. Më pas, neni 24 shprehet se “Për kërkesat që miratohen, në vendim shënohen përmbajtja dhe sasia e programeve në përputhje me këtë ligj”. Kjo mund të interpretohet si një kontroll i gjerë i KKRT-së mbi përmbajtjet e programeve, shumë më i gjerë sesa limitet e pranueshme të ndërhyrjes së shtetit apo autoriteteve publike në mënyrën se si ushtrohet liria e shprehjes.

Në zbatimin e këtyre dispozitave, duhet patur kujdes që KKRT-së të mos i jepet pushteti (më shumë se sa është e nevojshme për një autoritet rregullues të dijë se çfarë programesh ai po licenson, dhe për të vendosur kritere për monitorimin e tij përse i përket pajtueshmërisë më termat e licensës) për të ndërhyrë në përmbajtjet e programeve radiotelevizive. Çdo rishikim i ardhshëm i ligjit duhet ta

heqë këtë nënkuptim që KKRT-ja ka pushtetin të përcaktojë përmbajtjet e programeve.

Neni 31

Pushteti i KKRT-së që, në mënyrë të njëanshme, “të ndryshojë kushtet e përmendura në licencë edhe pa miratimin e mbajtësit të saj, në ato raste kur këto ndryshime diktohen nga respektimi i marrëveshjeve ndërkombëtare që ka nënshkruar Republika e Shqipërisë”, duket i tepruar. **Përfundimi i konventave ndërkombëtare dhe ratifikimi i tyre i mëpasshëm kërkojnë kohë të mjaftueshme që KKRT-ja të jetë në gjendje të bjerë dakort me transmetuesin për ndryshime në kushtet dhe termat e licencës.**

Nenet 36, 37, 66, 68

Sipas nenit 36, programet radiotelevizive publike dhe private duhet “të respektojnë të drejtat kushtetuese dhe të njeriut të pakicave kombëtare, në përputhje me konventat ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë” dhe “diversitetin fetar shqiptar”. Neni 66 angazhon RTSH-në t’i shërbejë të gjitha grupeve të shoqërisë, përfshi pakicat kombëtare.

Këto dispozita duket të shkojnë drejt plotësimit të kërkesave të dokumentave të tillë të Këshillit të Evropës si Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (Neni 9), dhe, veçanërisht, Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave (shih nenin 11).

Megjithatë, Neni 37 parashikon që përdorimi i gjuhës shqipe të jetë i detyrueshëm për të gjitha programet, përvec emisioneve drejtuar posaçërisht pakicave kombëtare, dhe programeve të subjekteve radiotelevizive vendore të licencuara për transmetim në gjuhën e pakicave.

Shtetet anëtare të OSBE-së njohin të drejtën e personave që i përkasin pakicave kombëtare “për të shpërndarë, pasur akses dhe për të shkëmbyer informacion në gjuhën e tyre” (Dokument i Vjenës, paragrafi 45; Dokumenti i Kopenhagenit, paragrafi 32.5). Ky qëndrim është zhvilluar mes të tjerash në Rekomandimet e OSBE-së në lidhje me të Drejtat Linguistike të Pakicave Kombëtare (Oslo, 1998) dhe Udhëzimet e OSBE-së për Përdorimin e Gjuhëve të Pakicave në Median Elektronike (tetor 2003).

Dokumenti i dytë formulon parimin që shtetet duhet të garantojnë lirinë e zgjedhjes përmes krijimit të një mjedisi, në të cilin mund të lulëzojnë një sërë idesh dhe informacionesh të komunikuar në gjuhë të ndryshme. Ai përcakton, gjithashtu, se “në rregullimin e përdorimit të gjuhës në median elektronike, shtetet mund të nxisin përdorimin e gjuhëve selektive. Masat për të nxitur një ose më shumë gjuhë nuk duhet të kufizojnë përdorimin e gjuhëve të tjera. Shtetet nuk mund të ndalojnë përdorimin e ndonjë gjuhe në median elektronike. Masat për promovimin e çdo gjuhe në median

elektronike nuk duhet të çenojnë gëzimin e të drejtave të personave që i përkasin pakicave kombëtare”.

Nuk është e qartë nëse ligji i përmbush të gjitha kërkesat e formuluar në këto dokumente. Për shembull, Udhëzimet e vitit 2003 i kërkojnë shteteve të “përcaktojnë kërkesat e duhura që duhet të përmbushen nga shteti apo transmetuesit publikë përsa i përket ofrimit të programeve në gjuhët e pakicave”. Shtetet duhet, gjithashtu, të garantojnë që koha që i vihet në dispozicion dhe programi i transmetimit në gjuhën e pakicave duhet të pasqyrojnë madhësinë në numër dhe përqendrimin e pakicave kombëtare, si dhe t’i përshtaten nevojave dhe interesave të tyre”. Megjithatë, neni 68 kërkon vetëm që RTSH-ja të ofrojë “informacion” për pakicat kombëtare. Udhëzimet thonë, gjithashtu, se “Shtetet duhet të mendojnë edhe për të krijuar kushte të favorshme (financiare apo të tjera) për të nxitur transmetimin privat në gjuhën e pakicave” dhe se “Aty ku nuk ka transmetim privat në gjuhën e pakicave, shtetet duhet të ndihmojnë në mënyrë aktive për ndërtimin e tyre, sipas nevojës”. **Në këtë ligj, nuk tregohet një politikë e qartë për arritjen e këtyre qëllimeve.**

Neni 39

Nuk është e pazakontë që legjislacioni i transmetimit të kërkojë që stacionet radiotelevizive të transmetojnë pa shpërblim njoftime zyrtare në kohë situatash të jashtëzakonshme ose fatkeqësish natyrore. Megjithatë, dispozita e këtij neni shkon shumë më larg se kaq, duke i detyruar stacionet publike dhe private të radiove të transmetojnë pa shpërblim çdo “mesazh me dobi shoqërore apo me interes të lartë për publikun e gjerë”, siç përcaktohet nga KKRT-ja.

Ky është një rast ndërhyrjeje e pajustificuar në lirinë editoriale dhe pavarësinë e transmetuesve, duke i kthyer ato në agjensi shtetërore informacioni. Kjo dispozitë duhet të hiqet.

Article 40/1

Ky nen ka për qëllim të mbrojë të drejtën e autorit. Në këtë kuptim, natyrisht, që ai meriton mbështetje. Megjithatë, kushti që transmetuesit duhet t’i paraqesin Këshillit Kombëtar të Radio dhe Televizionit “dokumenta që vërtetojnë se ata kanë të drejtën të transmetojnë programe në përputhje me kontratën e shitjes, shkëmbimit apo dhurimit për çdo program vështirë të jetë realist apo i zbatueshëm. KKRT-ja vështirë se mund të jetë në gjendje të përpunojë të gjitha këto dokumente pa vonesë, d.m.th. ato ose do të duhet të depozitoheshin shumë kohë përpara kohës së transmetimit, ose ky është në realitet një ligj që ekziston vetëm në letër dhe që nuk merret parasysh, pasi një dokumentacion i tillë nuk verifikohet para transmetimit të programit.

Ky është një kusht i tepërt, që përfshin më shumë detyrime, përpjekje administrative dhe kosto për transmetuesit, që potencialisht dëmton mundësinë e tyre për të reaguar shpejt ndaj ngjarjeve që ndodhin, duke prodhuar programe që i mbulojnë ato në kohën e duhur, dhe duke e mbingarkuar KKRT-në me shumë më

tepër shkresurina nga ç'është ajo e aftë të përpunojë. Kjo është një zgjidhje burokratike që nuk mund ta zgjidhë problemin real. Duhet të rishikohet.

Neni 40/2

Edhe “ndalimi i transmetimit të programeve nën logon e operatorëve të huaj radiotelevizivë” duket të jetë **joproporcional dhe i tepruar** – veçanërisht, nëse interpretohet edhe si ndalim i shfaqjes së klipeve të lajmeve ose sportit të stacioneve të tjera në emisionet e lajmeve të stacioneve televizive shqiptare.

Neni 41

Kriteri që stacionet publike dhe private radiotelevizive kombëtare duhet të transmetojnë lajme çdo ditë është e paqortueshme në vetvete. **Megjithatë, ajo duket se mbështetet në hipotezën se të gjitha programet do të jenë të përgjithshme. Kjo mund përjashtojë mundësinë e licencimit të kanaleve tematike, tema e të cilave mund t'i përjashtojë lajmet. Herët apo vonë, zhvillimi i tregut audioviziv do të çojë në lindjen e kanaleve të tilla, por ligji mund të përbënte një pengesë në këtë drejtim. Për t'u përgatitur për një gjë të tillë, duhet të shtohet një përkufizim për kanalet e specializuara, si dhe dispozita në kapitullin për licensimet në terma specifike për kanale tematike.**

Neni 43

Ky nen duket të jetë bazuar në “kronologjinë mediatike”, siç është përkufizuar në Direktivën TWF, para se ajo të ndryshohej në vitin 1997. Që atëherë, “kronologjia mediatike” e përkufizuar në mënyrë strikte është hequr nga direktiva dhe neni 7 tani thotë: “Shtetet anëtare garantojnë që transmetuesit nën juridiksionin e tyre të mos transmetojnë vepra kinematografike jashtë periudhave për të cilat është rënë dakort me zotëruesit e të drejtave”. **Gjithsesi, kjo është një çështje zgjedhjeje politike për Shqipërinë – derisa ajo të fillojë negociatat e hyrjes në Bashkimin Evropian – nëse dëshiron ta mbajë këtë dispozitë apo jo.**

Neni 44

Ndërsa mbrojtja e fshehtësisë së burimeve të informacionit gazetaresk ofruar nga ky nen mirëpritet, kushti i mjegullt që këto burime duhet të “zbulohen vetëm në raste të veçanta të parashikuara me ligj” përbën një arsye për t'u shqetësuar.

Rekomandimi Nr. R (2000) 7 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për të drejtën e gazetarëve për të mos zbuluar burimet e informacionit përmban udhëzime shumë të qarta për kufijtë e së drejtës së moszbulimit. E drejta e gazetarëve për të mos zbuluar informacione që identifikojnë një burim nuk duhet t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre të përmendura në nenin 10, paragrafin 2, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kur përcaktohet nëse një interes i ligjshëm për zbulim që hyn në fushën

e Nenit 10, paragrafi 2 i Konventës vlen më shumë se interesi publik për të mos e zbuluar informacionin që identifikon një burim, autoritetet kompetente të shteteve anëtare duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë rëndësisë së të drejtës së moszbulimit dhe epërsisë që i jepet asaj në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, dhe mund të urdhërojnë zbulimin vetëm nëse ekziston një kërkesë në interesin publik që i kalon gjithë te tjerat dhe nëse rrethanat kanë një natyrë mjaft jetësore dhe serioze.

Zbulimi i informacionit që identifikon një burim nuk duhet të gjykohet i nevojshëm, ne qoftë se nuk përcaktohet bindshëm që: (i) nuk ekzistojnë masa të arsytshme alternative ose ato janë ezauruar nga personat apo autoritetet publike që kërkojnë zbulimin dhe (ii) interesi i ligjshëm për t'i zbuluar është më i rëndësishëm se interesi publik për të mos i zbuluar, duke pasur parasysh se: provohet një kërkesë shumë e rëndësishme e nevojës për zbulim; rrethanat kanë një natyrë mjaftueshmërisht jetësore dhe serioze; nevoja e zbulimit identifikohet si përgjigje ndaj një nevoje sociale urgjente, dhe shtetet anëtare gëzojnë një kufi të caktuar vlerësimi të kësaj nevoje, por ky kufi shkon paralel me mbikqyrjen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Shtojca bashkëngjitur Rekomandimit specifikon më tej kushtet për deklarimin e burimit⁵.

Mbetet të shpresohet që ky nen të zbatohet në përputhje me këtë Rekomandim dhe gazetarëve të mediave elektronike t'u jepet një e drejtë shumë e fortë për të mbrojtur burimet e tyre të informacionit.

Neni 45

⁵ a. Mocioni ose kërkesa për ndërmarrjen e çfarëdoqj veprimi nga autoritetet kompetente që ka për qëllim deklarimin e informacionit që identifikon një burim duhet të paraqitet vetëm nga persona ose autoritete publike që kanë një interes të ligjshëm të drejtpërdrejtë në zbulimin e informacionit.

b. Gazetarët duhet të informohen nga autoritetet kompetente për të drejtën e tyre për të mos zbuluar informacione që identifikojnë një burim, ashtu si dhe për kufijtë e kësaj të drejte para se ky deklarim informacioni të kërkohej.

c. Sanksione kundër gazetarëve për moszbulim informacioni që identifikon një burim duhet të vendosen vetëm nga autoritetet gjyqësore gjatë ndjekjes gjyqësore, gjë që lejon zhvillimin e një seance dëgjimore me gazetarët e interesuar në përputhje me nenin 6 të Konventës.

d. Gazetarët duhet të kenë të drejtën që t'u rishikohet nga një autoritet tjetër gjyqësor një sanksion i vendosur mbi ta për moszbulimin e informacionit që identifikon një burim.

e. Aty ku gazetarët i përgjigjen një kërkesë ose urdhri për të zbuluar informacione që identifikojnë një burim, autoritetet kompetente duhet të marrin në konsideratë zbatimin e masave për të kufizuar masën e zbulimit, për shembull, duke e përjashtuar publikun nga zbulimi, në zbatim të nenit 6 të Konventës, aty ku duhet, dhe duke e respektuar edhe vetë fshehtësinë një zbulimi të tillë.

Ky nen prek një çështje shumë delikate në rregullimin e medias dhe formulimi i tij i paqartë dhe i përgjithshëm përbëjnë një arsye serioze për t'u shqetësuar.

Një konferencë rajonale e Këshillit të Evropës mbi shpifjen dhe lirinë e shprehjes në vendet e Evropës juglindore (17-18 tetor 2002) konstatoi se ligjet mbi shpifjen dhe fyerjen në disa vende të Evropës juglindore nuk arrijnë t'i japin një peshë të mjaftueshme të drejtës së lirisë së shprehjes; se edhe atje ku këto ligje janë të kënaqshme, praktika e zbatimit të tyre shpesh nuk arrin t'i japë peshën e mjaftueshme të drejtës së lirisë së shprehjes; dhe se zyrtarët publikë dhe të tjerë ndonjëherë abuzojnë me këto ligje.

Pjesëmarrësit ranë dakort njëzëri se duhet të ketë mbrojtje të së vërtetës dhe komenteve të drejta ku gazetarët kanë vepruar në mënyrë të arsyeshme dhe me qëllim të mirë; se barra për të provuar të vërtetën duhet t'i takojë në parim paditësit në rastet e shpifjes. Atje ku barra e provës i takon të paditurit, ky i fundit duhet, gjithashtu, të shkarkohet nga përgjegjësia, në qoftë se ai/ajo është në gjendje të sigurojë prova të arsyeshme që ai/ajo ka vepruar në mënyrë të arsyeshme dhe nisur nga një qëllim i mirë; se nuk duhet të ketë asnjë lloj mbrojtjeje si në ligjet substantive ashtu edhe ato procedurale apo në praktikë për zyrtarët publikë (duke përfshirë edhe Kryetarin e Shtetit), në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; në rastet e shpifjes dhe fyerjes duhet të inkurajohen rrugëzgjdhje alternative të efektshme për proceset gjyqësore, si ndërmjetësimi apo botimi i një ndjese, korrigjimi apo replike, me qëllim uljen e numrit të proceseve gjyqësore mbi këto baza. Aty ku përdoren të tilla rrugëzgjdhje alternative, nuk duhet të jetë e mundur që t'i drejtohesh proceseve gjyqësore; se duhet të merren masa për të parandaluar procese të tepërta gjyqësore.

Kjo çështje mbulohet, gjithashtu, gjerësisht në Deklaratën e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi lirinë e debatit politik në media, miratuar në vitin 2004.

Çdo rishikim i ardhshëm i këtij ligji duhet ta zhvillojë këtë dispozitë për të krijuar masa mbrojtëse për lirinë e shprehjes në përputhje me sa është sugjeruar më lart.⁶

Neni 46

Kushti që pasqyrat e përditshme dhe periodike në programet radiotelevizive “duhet të bëhet vetëm me lejen e botuesve të secilit organ shtypi” vendos një detyrim të panevojshëm dhe joproporcional mbi transmetuesit. Ky kusht duhet të hiqet.

⁶ Shih, gjithashtu, Toby Mendell, Dokument Bazë për Lirinë e Shprehjes dhe Shpifjen për Seminarin Ndërkombëtar për Promovimin e Lirisë së Shprehjes me Tre Mandatet e Specializuara Ndërkombëtare, Londër, 29-30 nëntor 2000.

Neni 47

Perkthimi në anglisht i këtij neni sugjeron një përjasje që në të vërtetë nuk mbështetet nga përmbajtja e tij. Në të vërtetë, ai ka lidhje me një të drejtë ose ndreqje (korrigjim) të informacionit të pavërtetë, që, shpesh, quhet “e drejta e replikës”, dhe jo e drejta e përgënjeshtimit, që do ta lejonte pretenduesin të hynte në një debat me pikëpamje të shprehura në një program në radio ose televizion.

Kapitujt VI dhe VII

Këto kapituj mbi reklamat dhe sponsorizimet nuk ngrenë ndonjë kundërshtim në formën e tyre aktuale. Megjithatë, një krahasim si me Konventën Evropiane të Televizionit Transkufitar dhe me direktivën “Televizion pa Kufij” do të tregojë se ato nuk rregullojnë *teleshopping* apo aktivitetet e transmetuesve për promovimin e vetes së tyre.

Harmonizimi në të ardhmen i këtij ligji me standartet e BE-së do të kërkojë përfshirjen e plotë të dispozitave të direktivës TWF dhe mënyrës për teknikat e reja reklamuese të miratuara në Komunikimin Interpretativ të Komisionit Evropian për Aspekte të caktuara të Dispozitave për Reklamat e transmetuara në Televizion në Direktivën “Televizioni pa Kufij”, C (2004) 1450, Bruksel, 23.4.2004.

Nenet 64-67

Këto nene përkufizojnë statutin, rolin dhe detyrimet për programet në përgjithësi të RTSH-së si një transmetues publik. Sipas ligjit të BE-së, ato duhet të shihen si dispozita që ia besojnë misionin e shërbimit publik RTSH-së, plotësuar në këtë drejtim nga Statuti i Radiotelevizionit Shqiptar, miratuar nga Kuvendi në vitin 2000.

Në Rekomandimin e tij No. R (96) 10 për Garancinë e Pavarësisë së Transmetimit Publik, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës rekomandon që shtetet anëtare “të përfshijnë në ligjin e tyre vendas ose në instrumentat që rregullojnë organizmat transmetues publik, dispozita që garantojnë pavarësinë e tyre”. Një shtojcë në këtë rekomandim shton se kuadri ligjor që rregullon organizmat transmetues publik duhet të përcaktojë qartë pavarësinë e tyre editoriale dhe autonominë institucionale.

Duhet theksuar se këto nene nuk e përshkruajnë RTSH-në si një organizëm të pavarur transmetues dhe as nuk thonë se RTSH-ja duhet të gëzojë pavarësi editoriale dhe autonomi institucionale – vetëm se ajo zotohet për një “mbulim të paanshëm të lajmeve të vendit dhe atyre ndërkombëtare” (neni 66). Siç do ta shohim më poshtë, mënyra e emërimit të Këshillit të saj Drejtues nga Kuvendi dhe fakti se edhe Statuti i RTSH-së duhet të miratohet nga Kuvendi, krijojnë mekanizma potencialë për ndërhyrje nga jashtë dhe për ushtrim presioni mbi RTSH-në.

Nga ky këndvështrim, mund të jetë domethënëse që forma ligjore dhe statusi i RTSH-së nuk përcaktohen fare, përveçse përshkruhet si “institucion” në nenin 64 (dhe “institucion kombëtar” në nenin 1 të Statutit).

Neni 64 shprehet se “Veprimtaria e Radiotelevizionit Publik Shqiptar rregullohet me këtë ligj”. Mbetet të shpresojmë se Ligji dhe Statuti janë me të vërtetë instrumentat e vetëm ligjorë që rregullojnë RTSH-në.

Në një rishikim të ligjit në të ardhmen ekziston një nevojë e qartë për dispozita të qarta që të shprehin pavarësinë e RTSH-së dhe të sigurojnë garanci për pavarësinë e saj.

Neni 69, 148

Neni 69 e kufizon RTSH-në që të përdorë vetëm teknologjinë tradicionale të transmetimit. Si e tillë, ajo nuk jep baza ligjore për një shërbim të mundshëm teleteksti dhe as për krijimin e një faqeje interneti. **Kjo nuk është një mënyrë trajtimi me perspektivë dhe, në të ardhmen, mund ta pengojë zhvillimin e RTSH-së dhe hyrjen e saj në botën e teknologjive të reja.**

Kjo duhet të korrigohet në një rishikim të mëvonshëm të ligjit, në mënyrë që RTSH-ja ta ketë derën të hapur për të përdorur teknologji të reja kurdo që të lindë nevoja dhe mundësia.

Rekomandimi Rec (2003) 9 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Masat për Promovimin e Kontributit Demokratik dhe Social të Transmetimit Numerik kërkon nga shtetet anëtare të “krijojnë kushtet e duhura financiare, teknike dhe të tjera për t’i dhënë mundësi transmetuesve publikë të përmbushin këtë detyrë në mënyrën më të mirë të mundur, ndërkohë që i përshtaten mjedisit të ri numerik”. Në vazhdim, rekomandimi thotë se: “Mjetet për të përmbushur detyrën e shërbimit publik mund të përfshijnë sigurimin e kanaleve të reja të specializuara, për shembull, në fushën e informimit, edukimit dhe kulturës, dhe shërbimeve të reja interaktive, si për shembull, Udhëzuesi i Programeve Elektronike, si dhe shërbime të tjera të programeve *on-line*. Transmetuesit publikë duhet të luajnë një rol qendror në procesion e kalimit drejt transmetimit numerik tokësor”.

Neni 148 parashikon që “Të gjitha frekuencat që janë aktualisht në përdorim të RTSH-së, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbeten në dispozicion të këtij institucioni për një periudhë 10-vjeçare”. **Nuk thuhet se çfarë do të ndodhë më pas. Kjo nuk përbën një bazë të sigurt mbi të cilën të ndërtohet e ardhmja e transmetimit publik në Shqipëri. Kjo dispozitë duhet të hiqet.**

Neni 70

Ky nen jep një listë të plotë të programeve që do të transmetohen nga RTSH-ja. Kjo mënyrë trajtimi është korrekte, meqenëse detyrimet e transmetuesit të programeve

duhet të përcaktohen qartë. Megjithatë, kjo është një listë e mbyllur, që nuk lejon ndryshime ose shtesa të programeve, nëse del një mundësi e tillë.

Për këtë arsye, do të ishte e këshillueshme që ky nen të plotësohej me dispozita që do t'i hapnin rrugë ndryshimeve në këtë listë dhe të përshkruanin procedurën sipas së cilës RTSH-ja do të merrte leje, mundësisht nga KKRT-ja, për të krijuar shërbime të reja programesh të mundshme.

Nenet 72-76

Këto nene kanë lidhje me pjesën e kërkuar të prodhimeve të RTSH-së, bashkëprodhimeve dhe prodhimeve të pavarura në kohën e transmetimit të RTSH-së (të paktën 50%, ku RTSH-ja ka të drejtë të përdorë deri në 25% të buxhetit të saj të destinuar për prodhimet e pavarura).

Këto dispozita do të duhet të ndryshojnë në mënyrë thelbësore gjatë procesit të harmonizimit me direktivën TWF, me prezantimin e një kuote evropiane (të paktën 50% të kohës së transmetimit, pa llogaritur kohën e caktuar për lajmet, ngjarjet sportive, lojërat, reklamat, shërbimet e teletekstit dhe teleshopping) dhe një kuotë për prodhimin e pavarur (të paktën 10% të kohës së transmetimit, pa llogaritur kohën e caktuar për lajmet, ngjarjet sportive, lojërat, reklamat, shërbimet e teletekstit dhe teleshopping, ose të paktën 10% të buxhetit të destinuar për prodhimin, ose të dyja, me një raport të mjaftueshëm të prodhimeve të kohëve të fundit, d.m.th. prodhimeve të transmetuara gjatë pesë vjetëve të fundit nga prodhimi i tyre) për të gjithë transmetuesit televizivë. Sipas rregullave të BE-së, çdo dispozitë që diskriminon prodhues nga shtete të tjera anëtare do të duhet të eliminohet (d.m.th. raporti i prodhimeve të vetë RTSH-së), por është e mundur që të përfshihet një kuotë – edhe kjo për të gjithë transmetuesit televizivë – për veprat që janë prodhuar fillimisht në gjuhën shqipe.

Disa shtete anëtare të BE-së prezantojnë nivele të ndryshme kuotash për transmetuesit televizivë privatë dhe publikë.

Meqenëse Shqipëria e nënshkroi dhe ratifikoi Konventën Evropiane për Televizionin Transkufitar në vitin 1999, disa prej këtyre dispozitave (domethënë kuota evropiane) duhet të ishin prezantuar ndërkohë në legjislacionin shqiptar për transmetimin.

Neni 77

Ky nen e vesh RTSH-në me të drejta ekskluzive transmetimi për veprimtari kulturore, artistike dhe sportive me interes kombëtar organizuar nga autoritete shtetërore qendrore ose vendore ose të financuara nga Buxheti i Shtetit, ashtu si dhe për veprimtari sportive në territorin e Republikës së Shqipërisë nga ekipe kombëtare të Republikës së Shqipërisë, ku federata kombëtare sportive, komitetet shqiptare të lojërave apo ndonjë institucion tjetër publik shqiptar kanë të drejtën e autorit ose të drejtat e transmetimit.

Edhe ky sistem që mbron transmetuesin publik nga konkurrenca e transmetuesve tregtarë do të duhet të ndryshojë plotësisht. Ashtu siç është tani, ai mund të shihet si një nen që i jep avantazh të padrejtë transmetuesit publik dhe që është kundër konkurrencës. Shqipëria e ka mundësinë të prezantojë një sistem që të mbrojë të drejtën e publikut për të ndjekur ngjarje me rëndësi të madhe për shoqërinë. Si Konventa Evropiane për Televizionin Transkufitar (shih nenin 9a) dhe direktiva TWF (shih nenin 3a) sigurojnë një bazë ligjore për prezantimin e një sistemi të tillë, ku asnjë transmetues nën juridiksionin e një shteti palë të Konventës, ose një shteti anëtar të BE-së nuk mund të transmetojë në mënyrë ekskluzive ngjarje, që nga ai vend konsiderohen si ngjarje me rëndësi madhore për shoqërinë, në atë mënyrë që do të privonte një pjesë të konsiderueshme të publikut në atë shtet anëtar nga mundësia për të ndjekur ngjarje të tilla nëpërmjet një mbulimi të drejtpërdrejtë ose një mbulimi me transmetim të regjistruar në një televizion pa pagesë (qoftë publik apo privat).

Një mënyrë tjetër për të mbrojtur të drejtën e publikut për t'u informuar është përfshirja e masave ligjore të parashikuara në nenin 9 të Konventës Evropiane për Televizionin Transkufitar, duke siguruar të drejtën për kronika të shkurtra informative mbi ngjarje që kanë shumë interes për publikun, për të cilat një transmetues ka marrë të drejta ekskluzive transmetimi ose ritransmetimi (shih, gjithashtu, Rekomandimin Nr. R (91) 5 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për të Drejtën për Kronika të Shkurtra Informative për Ngjarjet Madhore ku të Drejtat Ekskluzive për Transmetimin e Tyre Televiziv janë marrë në një kontekst transkufitar).

Nenet 85, 115-120

Nenet 85 dhe 115 e lejojnë RTSH-në të angazhohet në veprimtari tregtare, me çmime për përdorimin e mjediseve dhe pajisjeve të RTSH-së nga subjekte të tjera jashtë RTSH-së të verifikueshme nga KKRT-ja, me qëllim që të sigurohet një konkurrencë e ndershme midis transmetuesve.

Ky nen dhe gjithë sistemi i financimit të RTSH-së do të duhet t'iu përshtaten kërkesave të BE-së për sa i përket ndihmës nga shteti, siç përcaktohet në nenin 87(1) të Traktatit⁷, Protokollit të Amsterdimit⁸ dhe Komunikimit nga Komisioni për zbatimin e rregullave të ndihmës së shtetit për transmetimin publik (2001/C 320/04).

⁷ Ky nen thotë: "Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Traktat, çdo ndihmë dhënë nga një Shtet Anëtar ose nëpërmjet burimeve të një Shteti në çfarëdolloj forme, që prish ose që cenon të prishë konkurrencën duke favorizuar ndërmarrje të caktuara ose prodhimin e mallrave të caktuara, aq sa të ndikojë tregtinë në midis Shteteve Anëtare, do të jetë i papajtueshëm me tregun e përbashkët".

Shtetet Anëtare të BE-së janë të lira të zgjedhin mjetet e financimit të transmetimit publik, por kjo nuk mund të ndikojë konkurrencën në tregun e përbashkët në një mënyrë joproporcionale. Kjo do të thotë se niveli i financimit publik (tarifa e transmetimit, subvencionet dhe grantet e shtetit, etj) nuk mund ta tejkalojnë nivelin e nevojshëm për kryerjen e misionit të shërbimit publik. Gjithashtu, RTSH-së do t'i duhet të përfshijë llogari të dyfishta: (a) llogarinë e brendshme sipas veprimtarive të ndryshme, d.m.th. veprimtaritë e shërbimit publik dhe jopublik do të duhet të jenë të ndara; (b) të gjitha kostot dhe të ardhurat duhet të ndahen në mënyrë korrekte në bazë të parimeve të llogaritjes së kostos të zbatuara në mënyrë të vazhdueshme dhe objektivisht të justifikueshme; dhe (c) duhet të vendosen qartë parimet e analizës së kostos, sipas të cilave mbahen llogari të ndara.

RTSH-së do t'i duhet ta bëjë këtë dhe të përfshijë rregulla të tregtisë së ndershme, me qëllim që të tregojë se nuk ka subvencionim të tërthortë të veprimtarive komerciale nga financimi publik.

Nenet 86-90

Këto nene rendisin organet rregullatore të RTSH-së dhe përshkruajnë mënyrën e emërimit të Këshillit Drejtues.

Këshilli Drejtues i RTSH-së përbëhet nga 15 anëtarë të emëruar nga Kuvendi, ku përfshihen:

- 10 anëtarë të zgjedhur në mënyrë të barabartë ndërmjet njëzetë kandidatëve të propozuar nga maxhoranca dhe opozita, sipas përfaqësimit të tyre në Kuvend;
- 3 anëtarë të zgjedhur ndërmjet 6 kandidatëve të propozuar nga: Akademia e Shkencave; Universiteti i Tiranës; Shoqatat e Shkrimtarëve dhe Artistëve;
- 2 anëtarë të emëruar ndërmjet katër kandidatëve të propozuar nga shoqatat e gazetarëve.

Në një shtojcë të Rekomandimit Nr. R (96) 10 për Garancinë e Pavarësisë së Transmetimit Publik, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës kërkon që rregullat që rregullojnë statusin e organeve mbikëqyrëse të organizmave të transmetimit publik, sidomos anëtarësinë e tyre, të përkufizohen në mënyrë të tillë që të shmangin rrezikimin e këtyre organeve nga ndërhyrjet politike apo të tjera.

Më tej, ai thotë:

“Këto rregulla duhet, në veçanti, të garantojnë që anëtarët e organeve mbikëqyrëse:

- të jenë emëruar në mënyrë të hapur dhe pluraliste;
- të përfaqësojnë në mënyrë të përbashkët interesat e shoqërisë në përgjithësi;

⁸ Ky Protokoll thotë se financimi për transmetuesit publikë nuk duhet të “prekë kushtet e tregtisë dhe konkurrencës në komunitet deri në atë masë që do të ishte në kundërshtim me interesin e përbashkët, ndërsa detyra e atij shërbimi publik duhet të merret parasysht”.

- të mos marrin ndonjë mandat apo udhëzime nga persona apo organe të tjera përveç atij që i emëron ata, me përjashtim të dispozitave të kundërta përcaktuar nga ligji në raste të veçanta”.

Duke pasur parasysh se 10 anëtarë të Këshillit Drejtues të RTSH-së janë të emëruar politikë, dhe se ata kanë një shumicë të qartë në Këshill, vështirë të thuhet se janë arritur këto kushte në Shqipëri: (i) mënyra e emërimit të Këshillit është vetëm pjesërisht e hapur dhe pluraliste; (ii) anëtarët nuk përfaqësojnë plotësisht në mënyrë të përbashkët interesat e shoqërisë në përgjithësi; (iii) ka të ngjarë që të paktën disa prej anëtarëve të ndikohen nga udhëzime politike. Sistemi aktual është ndërtuar në mënyrë të tillë që çdo parti e përfaqësuar në Kuvend të ketë përfaqësuesin e saj në Këshill, duke e bërë Këshillin një shtojcë të Kuvendit, dhe duke e kthyer RTSH-në potencialisht jo në një transmetues publik, por në një transmetues “parlamentar”.

Më e mira do të ishte që të gjithë kandidatët për anëtarë të Këshillit Drejtues të propozoheshin nga organizata dhe organe kombëtare profesionale dhe të shoqërisë civile dhe të emëroheshin nga Kuvendi ndërmjet dy kandidatëve të propozuar për çdo vend. Për këtë qëllim, ligji do të duhej të jepte listën e 15 “propozuesve” (organizata, organe, ose grupe organizatash të ngjashme me autoritetin për të propozuar kandidat për një vend), të përzgjedhur, në mënyrë që anëtarët e Këshillit të përfaqësonin vërtet së bashku interesat e shoqërisë në përgjithësi.

Neni 90

Lista e papajtueshmërive për anëtarët e Këshillit Drejtues duhet të zgjerohet në mënyrë që të mbulojë edhe prodhuesit e pavarur dhe personelin e tyre, si dhe pronarët dhe punonjësit e agjencive të reklamave.

Nenet 99-114

Këto nene përshkruajnë kompetencat dhe marrëdhëniet reciproke midis tre “organeve drejtuese” të RTSH-së.

Ndarja e punës midis tyre mund të përshkruhet si më poshtë:

- Këshilli Drejtues merret me çështje administrative, organizative dhe programuese;
- Bordi Administrativ fokusohet kryesisht në çështjet financiare;
- Drejtori i Përgjithshëm administron RTSH-në në fushën e programimit, veprimtarive financiare dhe biznesit.

Ky sistem ngre një sërë pyetjesh:

1. Sipas nenit 99, Këshilli Drejtues privohet nga pothuajse çdo lloj mbikëqyrjeje mbi financat e RTSH-së. Në fakt, Statuti i RTSH-së i jep atij autoritetin të miratojë planin vjetor financiar dhe buxhetin e RTSH-së dhe njërive të tij përbërëse (shih nenin 16,

paragrafi 1, pika dh, e Statutit), por kjo nuk mbështetet nga ligji. Një ndryshim i Statutit do ta privonte atë nga kjo kompetencë. **Kjo duhet të korrigjohet dhe ky autoritet i Këshillit Drejtues duhet të garantohet me ligj, meqenëse është e pamundur që Këshilli Drejtues të mbikëqyrë me efektshmëri veprimtarinë e RTSH-së, nëse ai privohet nga e drejta për t'u shprehur mbi çështjet financiare.**

2. Pse i është dhënë Bordit Administrativ një lloj autoriteti vendimmarrës (shih nenin 113) në këtë fushë kyçe, i cili përshkruhet në nenin 104 si “një organ këshillimor i Drejtorit të Përgjithshëm” dhe që në të vërtetë nuk është i pavarur nga Drejtori i Përgjithshëm (ai/ajo propozon kandidatë për emërim në Bord, mund të propozojë largimin e tyre nga detyra dhe të përcaktojë shpërblimin e anëtarëve)? **Është Këshilli Drejtues ai që duhet të miratojë buxhetin e RTSH-së dhe që duhet të marrë vendimet që tani i rezervohen Bordit Administrativ në nenin 113 (sidomos blerja, shitja dhe lënia peng e pasurisë; marrja dhe shlyerja e kredive bankare; si dhe përfundimi i kontratave për investime të reja, kur shuma për t'u investuar nga RTSH-ja është mbi 5-10 për qind e buxhetit vjetor të institucionit).**
3. Pse mund të kenë anëtarët e Bordit Administrativ tre mandate 4-vjeçare të njëpasnjëshme, kur anëtarët e Këshillit Drejtues mund të rizgjidhen vetëm tre vjet pas përfundimit të mandatit të tyre të fundit?

Për të zgjidhur dilemën e pavarësisë së supozuar të Bordit Administrativ, kur, në realitet, ai mund të kontrollohej lehtë nga Drejtori i Përgjithshëm, ai mund të përkufizohet si një organ këshillimor i Këshillit Drejtues dhe t'i raportonte Këshillit dhe jo Drejtorit të Përgjithshëm. Kjo do të kërkonte një ndryshim në ligj, që t'i heqë Drejtorit të Përgjithshëm të drejtën e kontrollit mbi Bordin Administrativ.

Nent 121-127

Këto nene kanë të bëjnë me “Programet Radiotelevizive Kabllore”, të cilat, në pamje të parë, mund të nënkuptojnë si sistemet televizive të rishpërndarjes dhe ato kabllore. Edhe një herë, mungesa e një përkufizimi të saktë të termave (në këtë rast “Transmetim” dhe “ritransmetim”⁹) sjell një paqartësi ligjore në këto dispozita.

Neni 122 rendit llojet e mëposhtme të “programeve radiotelevizive kabllore”:

1. Ritransmetimin e programeve nga transmetues tokësorë dhe satelitorë, duke përfshirë gjithmonë programe të operatorëve publikë;
2. Ritransmetimin e programeve të destinuara për rrjete të mbyllura televizive si hotele, shtëpi të moshuarish, rezidenca turistike, fshatra turistike, anije, tragete, spitale, kinema, teatro dhe diskoteka;

⁹ Konventa Evropiane për Televizionin Transkufitar i përkufizon ata si vijon: “Transmetim” do të thotë emetim fillestar me transmetues tokësor, kabllor, satelit apo çfarëdolloj transmetuesi tjetër, në mënyrë të koduar ose të pakoduar, të programeve televizive për marrje nga publiku i gjerë. Nuk përfshihen shërbimet e komunikimit që veprojnë në bazë të kërkesave individuale; “Ritransmetim” nënkupton marrjen dhe transmetimin në të njëjtën kohë, pavarësisht nga mjetet teknike të përdorura, të shërbimeve të plota dhe të pandryshuara televizive, ose pjesëve të rëndësishme të shërbimeve të tilla, të transmetuara nga transmetuesit për t'u marrë nga publiku i gjerë;

3. Ritransmetim të prodhimeve audiovizive të regjistruara me mjete të ndryshme;
4. Transmetimi i programeve të ndryshme të prodhuara vetë.

Nuk është e qartë pse pika 2 i referohet “ritransmetimit” të programeve të destinuara për rrjete të mbyllura televizive (që do të kishte kuptimin e marrjes dhe ritransmetimit diku tjetër), ndërsa, në fakt, ajo duhet ndoshta t’i referohet “transmetimit” të shërbimeve të tilla për qëllimin dhe vendet për të cilën ato janë të destinuara.

Neni 122

Ky nen prezanton një dispozitë detyruese, që kërkon që operatorët kabllorë t’i ritransmetojnë gjithmonë shërbimet e programeve të “operatorëve publikë” – që ndoshta do të thotë RTSH-së. Nuk është e qartë nëse e ka fjalën për të dy shërbimet, si për atë kombëtar dhe për atë rajonal të programeve. **Për një sistem kabllor në një rajon, mund të jetë e vështirë të ritransmetojë një shërbim programesh rajonal të RTSH-së nga një rajon tjetër, në qoftë se zona e tij e mbulimit nuk e mbulon zonën ku vepron sistemi kabllor.**

Me kalimin e kohës, do të jetë e nevojshme që të bëhet vlerësimi i kësaj dispozite për të parë pajtueshmërinë e saj me dispozitat për këtë çështje në Direktivën 2002/22/EC të Kuvendit Evropian dhe Këshillit të datës 07 mars 2002 për shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesve lidhur me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.

Nenet 123, 126, 135

Duket se neni 123 i referohet vetëm licencimit të shërbimeve të reja dhe origjinale të programeve të prezantuara nga operatorët kabllorë në sistemet e tyre (pika 4 e nenit 122). Në qoftë se është kështu, kjo, pa dyshim, që është e paqortueshme. **Do të ishte ndryshe në qoftë se operatori kabllor do të kishte nevojë për një licencë për të transmetuar dhe ritransmetuar programe. Kjo do të thotë se një shërbim programesh i licencuar në një vend tjetër do të licencohej, në fakt, edhe një herë në Shqipëri vetëm për qëllime ritransmetimi. Kjo do të përbënte një shkelje të ligjit ndërkombëtar.**

Megjithatë, në qoftë se prezumimi është i saktë, atëherë kjo do të thotë se ritransmetimi nga operatorë kabllorë i çdo lloj programi tjetër tokësor apo satelitor (vendas apo i huaj) është i parregulluar, përveç rregullit detyrues në nenin 122. Megjithatë, duhet të vihen re dy dispozita të tjera në këtë drejtim.

Neni 126 parashikon se “për të realizuar transmetim cilësor të zërit dhe figurës për pajtimtarët nëpërmjet rrjeteve kabllore të telekomunikimit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në bashkëpunim me Agjencinë Rregullatore të Telekomunikacionit, përcakton rregullat dhe mënyrat e shpërndarjes së programeve radiotevizive”. Mënyra dhe procedura, nëpërmjet së cilës KKRT-ja “përcakton rregullat dhe mënyrat” nuk përkufizohen, dhe as nuk është e qartë nëse “shpërndarje” do të thotë “transmetim” apo “ritransmetim”. **Ky mund të jetë tregues i mungesës së një sigurie**

ligjore për operatorët kabllorë dhe i pushtetit për të vepruar që i është dhënë KKRT-së në këtë drejtim.

Së dyti, duhet vënë në dukje se neni 135 ndalon “ritransmetimin me kabëll për qëllime fitimi të programeve satelitore nga individë që kanë pajisje të tilla marrëse”.

Me sa duket ky nen i referohet individëve që nuk janë operatorë kabllorë që veprojnë në bazë të një “leje për rrjete kabllore” (shih nenin 127). Në qoftë se është kështu, “individë” të tillë do të çënonin ligjin e telekomunikacionit. Përsa i përket lirisë së shprehjes garantuar me nenin 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, dhe lirisë së marrjes dhe ritransmetimit të programeve transkufitare parashikuar në Konventën Evropiane të Televizionit Transkufitar dhe direktivës TWF, çështja është më pak e qartë. Në rastin e Autronic AG, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka rrëzuar kufizimin e ritransmetimit si formë censure apo ndërhyrjeje në përmbajtjen e një transmetimi.

Nenet 128-134

Këto dispozita kanë lidhje me përsëritësit radiotelevizivë, ritransmetimin e programeve vendase ose të huaja në zona të ndryshme të vendit dhe licencimin e transmetuesve të angazhuar në një aktivitet të tillë.

Rregullat që rregullojnë këtë formë transmetimi përbëjnë shkaqe për shqetësime serioze, sepse:

1. Ato kërkojnë të vendosin kufizime mbi përmbajtjen (“Stacionet e transmetuara nga përsëritësit nuk e prekin publikun dhe rendin kushtetues të Republikës së Shqipërisë” – neni 130, pika 2) që mund të interpretohej si një nen që e shtrin juridiksionin shqiptar mbi programet e huaja;
2. Ato duket të shfaqin një lloj preference për programet vendase të licensuara në krahasim me ato të huaja (shih nenet 129, 133);
3. Bazat për heqjen e licensave të tilla duket të jenë shumë më tepër arbitrare se në rastin e licensave për transmetimin e programeve vendase, duke i lënë KKRT-së pothuajse dorë të lirë (shih nenet 131, 133).

Ndërkohë që një lloj preference për programe të reja që vijnë nga transmetuesit vendas mund të jetë e kuptueshme, këto dispozita konfirmojnë atë që u përshkrua më sipër si një tendencë kundër programeve të huaja që hyjnë në Shqipëri.